



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 60/2023 (JR)
Nr. 60/ 3 regj.

Tiranë, më 21.06.2023

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e premte, në datën 14.07.2023, ora 9:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri (JR) 60/2023, datë 28.04.2023, për kërkesën e kërkuarit Maksim Sota, për rivendosjen në afat të së drejtës për ankim ndaj vendimit nr. 510, datë 17.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca gjyqësore në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.


Trupi Gjyqësor përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjyqësor
Relatore e Çështjes
Anëtare
Anëtare
Anëtare

Sokol Çomo
Albana Shtylla
Natasha Mulaj
Mimoza Tasi
Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të kërkuarit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit.

KRYESUES I TRUPIT GJYKËS

GJYQTAR

SOKOL ÇOMO

